



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1598/4 prot.

Datë 23.09.2021

V E N D I M

Nr. 666/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF-02357-08-05-2021 me objekt: “Blerje Shtypshkrime”, me fond limit 3,193,257.10 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rama Graf” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Adel CO” SHPK
Rruga “Muhamet Gjollësia”, Zogu i Zi, Tiranë

Operatori ekonomik “Rama Graf” SHPK
Lagjja: Kongresi i Elbasanit” Elbasan

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.
Rruga: “Kolë Heqimi 11” Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.08.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF-02357-08-05-2021 me objekt: “Blerje

Shtypshkrime”, me fond limit 3,193,257.10 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 16.08.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 24.08.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si vijon:

“KRISTALINA.KH” SHPK	2.167.920 lekë, skualifikuar
“RAMA - GRAF” SHPK	2.179.150 lekë, skualifikuar
“Adel CO” SHPK	2.259.386,60 lekë, skualifikuar
“Inpress” SHPK	2.432.495 lekë, skualifikuar
“F.L.E.SH.” SHPK	2.443.960 lekë, skualifikuar

II.4. Në datën 24.08.2021 operatori ekonomik “Adel CO” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Oferta juaj eshte oferte anomalisht e ulet.Ne baze te nenit 93 te ligjit nr 162/2020 Per Prokurimin Publik :Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë .Prane sekretarise se institucionit tone nuk eshte protokolluar asnje kthim pergjigje ne lidhje me sqarim e kerkuar ne SPE nga ana juaj brenda tri ditëve pune.

II.5. Në datën 26.08.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 26.08.2021, operatori ekonomik ankimues “Adel CO” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1598/2 date 27.08.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Adel CO” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.6. Me shkresën nr. 1956/4 prot, datë 03.09.2021 me objekt: “Dërgohet vendimi mbi ankesën”, protokolluar me tonën me nr. 1598/3 prot datë 07.09.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adel CO” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në datën 24.08.2021 operatori ekonomik “Rama Graf” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Afati i vlefshmërisë për sigurimin e ofertës është 30 ditë ,ku ne DST është 150 ditë.

II.10. Në datën 26.08.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit.

II.11. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 30.08.2021, operatori ekonomik ankimues “Rama Graf” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij.

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1615/2 date 31.08.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Rama Graf” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.13. Me shkresën nr. 1956/3 prot, datë 03.09.2021 me objekt: “Dërgohet vendimi mbi ankesën”, protokolluar me tonën me nr. 1615/3 prot datë 07.09.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rama Graf” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 10.09.2021, operatori ekonomik ankimues “Rama Graf” SHPK ka paraqitur argumente (formular i paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK se: *“Oferta juaj eshte oferte anomalisht e ulet. Ne baze te nenit 93 te ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik :Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë . Prane sekretarise se institucionit tone nuk eshte protokolluar asnje kthim pergjigje ne lidhje me sqarim e kerkuar ne SPE nga ana juaj brenda tri ditëve pune.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 17 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.*

Përfundimisht, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore, sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Rastet kur mund të përdoret komunikimi në rrugë shkresore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe parashikimet e këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik si më poshtë:

a) informacionet që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, duhet të jenë në dispozicion të palëve të interesuara;

b) mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës.

3. Në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese, të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produkte të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

Forma e përdorur për komunikim, shkëmbim dhe ruajtjen e informacionit duhet të garantojë se autoriteti ose enti kontraktor mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave

për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj.

III.1.2. Në nenin 10 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, parashikon se “Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit, si rregull, bëhet në përputhje me nenin 17, të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të komunikojë, në formë shkresore, vetëm në rastet e mëposhtme: a) kur, për shkak të natyrës së veçantë të prokurimit, për komunikimin elektronik do të nevojiteshin pajisje, mjete apo formate të posaçme, të cilat nuk janë të disponueshme gjerësisht apo nuk suportohen nga aplikacione të disponueshme gjerësisht; 11 b) kur aplikacionet që suportojnë formatet e dokumenteve që janë të përshtatshme për përshkrimin e ofertave përdorin formate që nuk mund të trajtohen nëpërmjet aplikacioneve të hapura apo të disponueshme gjerësisht ose janë të regjistruara si pronësi intelektuale dhe nuk mund të vihen në dispozicion për t’u shkarkuar apo përdorur në distancë nga ana e autoritetit ose entit kontraktor; c) kur për përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit nevojiten pajisje zyre të posaçme që nuk janë gjerësisht të disponueshme për autoritetet/entet kontraktore; ç) për procedura prokurimi ose faza të tyre, të cilat kërkojnë dorëzimin e modeleve, projekteve ose maketeve, të cilët nuk mund të transmetohen nëpërmjet mjeteve elektronike.. [...]”

III.1.3. Në Manualin Nr. 01, datë 26.01.2018 “Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, pika 8, “Kërkesa” parashikohet se: “Tek skedari “Kërkesat” - “Kërkesat nga AK” operatori ekonomik do të gjejë kërkesat e dërguara nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me ofertat e dorëzuara në procedurat e prokurimit në sistem. Për tu përgjigjur kërkesës së ardhur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, operatori ekonomik duhet të klikojë dy herë mbi kërkesen. Në dritaren që shfaqet duhet të plotësojë tek seksioni “Përgjigjia” fushën “Përshkrim”, si dhe “Materiali i bashkangjitur” dhe më pas duhet të klikojë butonin “Ruaj” dhe “Ruaj dhe Mbyll”.

Tek skedari “Kërkesat” - “Kërkesat të tjera”, operatori ekonomik mund të shikojë të gjitha kërkesat e bëra nga operator të ndryshëm, si dhe përgjigjet e dhëna nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, këto kërkesa bëhen pjesë e procedurës së prokurimi dhe mund të shikohen edhe duke klikuar dy herë mbi procedurën përkatëse tek skedari “Procedurat e publikuara” dhe më tej duke klikuar mbi menunë e emërtuar “Kërkesat”

Kujdes: Në rast se një operator ekonomik ankohet për kriteret e kualifikimit dhe/apo specifikimet teknike, kjo ankesë duhet të jetë me shkrim dhe të administrohet në po këtë mënyrë nga ana e autoritetit kontraktor. Përgjigja e autoritetit kontraktor për ankesën bëhet po me shkrim dhe këto administrohen në dosjen e prokurimit.

III.1.4. Referuar Sistemit të Prokurimeve Elektronike rezulton se operatori ekonomik “Adel Co” ShPK është njoftuar në datën 19.08.2021 në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor me objekt: “kërkesë për shpjegime në lidhje me ofertën anomalisht të ulët”, në të cilën autoriteti kontraktor i ka kërkuar sqarime në përputhje me nenin Neni 93 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III.1.5. Referuar Sistemit të Prokurimeve Elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Adel Co” ShPK me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur Shkresë datë 23.08.2021 me lëndë: “Shkresë për argumentim oferte anomalisht të ulët”.

III.1.4. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në datën 19.08.2021 autoriteti kontraktor ka dërguar nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike kërkesën drejtuar operatorit ekonomik ankimues, ku ky i fundit të paraqesë me shkrim brenda tri ditëve pune shpjegime në lidhje me ofertën anomalisht të ulët referuar nenit 93 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në datën 23.08.2021 operatori ekonomik ankimues i është përgjigjur kërkesës së autoritetit kontraktor për “Sqarim oferte anomalisht të ulët” në sistemin elektronik të prokurimeve duke dhënë argumentet e tij në lidhje me ofertën anomalisht të ulët. Referuar arsyes së skualifikimit, dhënë nga autoriteti kontraktor, se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar në formë zyrtare, por elektronikisht në Sistemin Elektronik të Prokurimeve argumentet lidhur me ofertën anomalisht të ulët, Komisioni i Prokurimit Publik e gjen të pabazuar në ligj. KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka gabuar duke refuzuar të marrë në shqyrtim informacionin e dërguar në formë elektronike dhe të administruar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve në rubrikën “Kërkesat”, nga operatori ekonomik ankimues me qëllim justifikimin e ofertës anomalisht të ulët, pasi mënyra e zgjedhur nga operatori ekonomik për të argumentuar ofertën anomalisht të ulët është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Konkretisht nenit 17 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *1. I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit.* Akoma më tej referuar Manualit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 01, datë 26.01.2018 “Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, të sipërcituar rezulton të jetë e detajuar mënyra e komunikimit elektronik midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë për të gjitha kërkesat që administrohen nga Sistemi Elektronik i Prokurimeve, i cili përfshin patjetër edhe marrjen e informacionit nga autoriteti kontraktor të informacionit dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, nuk qëndron pasi autoriteti kontraktor referuar sa më sipër, duhet të kishte marrë në shqyrtim pretendimet mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rama Graf” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “[...]Afati i vlefshmerisë për sigurimin e ofertës është 30 ditë, ku në DST është 150 ditë. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2, të shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

[...]

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës 63 865.142 (gjashtedhjetë e tre mijë e teteqind e gjashtedhjetë e pese pike 142)leke pa tvsh

III.2.2. Në seksionin 3 “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

3.2 Periudha e vlefshmësisë së ofertës: 150(shprehur në ditë)

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Rama Graf” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Formulari i Sigurimit të ofertës lëshuar më 14.08.2021 në të cilin parashikohet se: “[...] Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 30 ditë.[...]”

III.2.4. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.6. Në nenin Neni 83 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

III.2.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me

sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.2.8. Sa më sipër Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin formularin e sigurimit të ofertës (Shtojca 3), në të cilin është parashikuar periudha e vlefshmërisë së ofertës 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Rama Graf” ShPK konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka dorëzuar dokumentin formulari i sigurimit të ofertës, në të cilin parashikohet se *“[...] Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 30 ditë.[...]”*. Sa më sipër KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Rama Graf” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me Nr. REF-02357-08-05-2021 me objekt: “Blerje Shtypshkrime”, me fond limit 3,193,257.10 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rama Graf” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rama Graf” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri